



BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

22.01.2021

Procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit

TEZA 4

ALTERNATIVA (10 x 1 pikë)

1. Cila nga të mëposhtmet nuk përfshihet në parimet themelore të etikës profesionale:

- a. Integriteti dhe objektiviteti
- b. Konfidencialiteti dhe objektiviteti
- c. Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur
- d. Sjellja profesionale dhe integriteti
- e. Konfidencialiteti dhe integriteti
- f. Prudencialiteti dhe objektiviteti
- g. Kompetenca profesionale dhe konfidencialiteti
- h. Kujdesi i duhur dhe integriteti

Përgjigje e saktë është alternativa F

2. Cili nga të mëposhtmit nuk përbën një nga qëllimet pse një firmë audituese harton politika dhe procedura të pavarësisë:

- a. Të komunikojë këto kërkesa tek personeli i saj
- b. Të komunikojë këto kërkesa, kur është e nevojshme, edhe tek të tjerët që i nënshtrohen pavarësisë
- c. Të identifikojë dhe vlerësojë rrethanat dhe marrëdhëniet që krijojnë kërcënime ndaj pavarësisë
- d. Të ndërmarrë veprimet e duhura për t'i eliminuar kërcënimet ndaj pavarësisë
- e. Të ndërmarrë veprimet e duhura për t'i zvogëluar kërcënimet e pavarësisë në një nivel të pranueshëm
- f. Të zbatojë masave mbrojtëse për t'i zvogëluar kërcënimet e pavarësisë
- g. Të tërhiqet nga angazhimi përpara nënshkrimit të letrës së angazhimit nëse identifikohen kërcënime të rëndësishme ndaj pavarësisë
- h. Të tërhiqet nga angazhimi, kur tërheqja është e mundur sipas ligjeve dhe rregullave të zbatueshme, nëse kërcënimet nuk zvogëlohen dot në një nivel të pranueshëm

Përgjigje e saktë është alternativa G

3. Çfarë konsideron SNA 240 si një rrezik të konsiderueshëm?

- a. Rreziqet që lidhen me regjistrimet në ditar
- b. Rreziku i anashkalimit të kontroleve nga ana e drejtimit
- c. Rreziku që njësisia ekonomike ka pasur një fitim më të lartë në vitin aktual sesa viti i kaluar
- d. Rreziku nga mos identifikimi të mashtrimit nga ekipi i auditimit
- e. Rreziku që lidhet me klasa transaksionesh, teprica llogarie, ose informacione të dhëna
- f. Rreziku i ndryshimit të partnerit të auditimit nga ana e audituesit

- g. Asnjë nga të mësipërmet
- h. Të gjitha më sipër

Përgjigje e saktë është alternativa B

4. Cili nga elementet e mëposhtëm përfshihet në një “informacion tjetër” financiar që shoqëron pasqyrat financiare të auditura të një Shoqërie?

- a. Treguesit kryesore të performancës financiare
- b. Të dhëna mbi shpenzimet e personelit
- c. Modeli i biznesit
- d. Shpenzime kapitale të planifikuara
- e. Vlerësimi i rreziqeve të biznesit dhe manaxhimi i tyre
- f. Vlerësimi i rreziqeve financiare dhe manaxhimi i tyre
- g. Të gjitha më lart
- h. Asnjë nga më lart

Përgjigje e saktë është alternativa G

5. Përfshirja e një paragrafi “të theksimit të çështjes” në një raport auditimi, kur audituesi nuk ka zbuluar anomali materiale dhe as të përhapura dhe kur të gjitha kushtet e tjera supozohen të pandryshuara, bën që raporti të karakterizohet si?

- a. Raport me opinion me rezervë
- b. Raport me opinion të pamodifikuar
- c. Raport me opinion të kundërt
- d. Raport me refuzim dhënie opinion
- e. Raport me paragraf “çështje të tjera”
- f. Raport me paragraf “informacione të tjera”
- g. Alternativa e) dhe f) janë të sakta
- h. Asnjë nga alternativat më lart

Përgjigje e saktë është alternativa B

6. Çfarë do të përbënte materialitetin e performancës në përputhje me SNA 320?

- a. Një shumë e caktuar në 50% të nivelit të përgjithshëm të materialitetit
- b. Një shumë nën nivelin e përgjithshëm të materialitetit, e cila është vendosur në mënyrë të rastësishme nga audituesi
- c. Një shumë që është më e vogël se niveli i përgjithshëm i materialitetit i caktuar nga audituesi duke marrë parasysh rrezikun e përgjithshëm të deklaramit të gabuar material të lidhur me auditimin dhe rreziqet specifike, si dhe gabimet e kaluara të pakorrigjuara dhe probabilitetin e ekzistencës së gabimeve të pazbuluara
- d. Një shumë / ose shuma më të larta se niveli i përgjithshëm i materialitetit
- e. Një shumë e barabartë me nivelin apo nivelet e materialitetit për klasa të veçanta të transaksioneve, teprica në llogari ose informacione shpjeguese të dhëna
- f. E njëjtë me shumën e zërave tek të cilët synohet të përqëndrohet vëmendja e përdoruesve të pasqyrave financiare të entitetit
- g. Asnjë nga të mësipërmet
- h. Të gjitha më sipër

Përgjigje e saktë është alternativa C

7. Audituesit mund të përballen me sfida nëse janë mbështetur në forma jo të mjaftueshme të evidencës së auditimit. Cila nga më poshtë është evidencë e përshtatshme në mënyrë që audituesi të jetë në gjendje të nxjerrë konkluzione të arsyeshme mbi të cilat do të bazohet opinionin e tij.

- a. Zgjedhja e kampionit me vlerën e ponderuar
- b. Testet e kontrollit
- c. Konfirmimi i drejtpërdrejtë nga palët e treta
- d. Diskutim me personat që janë të ngarkuar me drejtimin.
- e. Testet e kontrollit e kombinuar me zgjedhjen e kampionit
- f. Projektimi i anomalive
- g. Asnjë nga të mësipërmet
- h. Të gjitha më sipër

Përgjigje e saktë është alternativa C

8. SNA 402 ‘Konsiderata gjatë Auditimit të Entiteteve që Përdorin Organizata për Shërbime’ kërkon që audituesi të kuptojë shërbimet e ofruara nga organizata të jashtme dhe të përdorura nga njësi ekonomike raportuese në lidhje me:

- a. Shërbimet që janë pjesë e sistemit të informacionit të njësisë ekonomike, dhe janë të rëndësishme për raportimin financiar
- b. Çdo shërbim të marrë
- c. Shërbimet e ofruara për palët e treta
- d. Vetëm shërbimet e IT-së
- e. Vetëm shërbimet që lidhen me palët e lidhura
- f. Shërbimet që janë dhënë nga palë që operojnë jashtë vendit nga ku zhvillon aktivitetin njësi ekonomike
- g. Asnjë nga të mësipërmet
- h. Të gjitha më sipër

Përgjigje e saktë është alternativa A

9. Nëse gjatë procesit të auditimit, audituesi nuk pengohet nga drejtimi i njësisë ekonomike në marrjen e informacionit që do t’i nevojitet në lidhje me vlerësimin e përputhshmërisë dhe zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi dhe konstaton që nuk ka as anomali materiale dhe as të përhapura duke supozuar gjithë kushtet e tjera mbeten të pandryshuara, atëherë audituesi duhet të lëshojë një opinion:

- a. Opinion standard me paragrafin ‘theksim çështje’
- b. Opinion të kundërt
- c. Opinion të pamodifikuar
- d. Opinion me rezerve ose refuzim dhënie opinionin
- e. Opinion standard me paragraf “çështje të tjera”
- f. Asnjë nga më lart
- g. Të gjitha më lart
- h. Alternativa b), d) dhe e) janë të sakta

Përgjigje e saktë është alternativa C

10. Një angazhim për dhënien e sigurisë në të cilën një palë e ndryshme nga profesionisti i praktikës, mat ose vlerëson çështjen në fjalë kundrejt kritereve është:

- a. Angazhim për dhënien e një sigurie të arsyeshme
- b. Angazhim për dhënien e një sigurie të kufizuar

- c. Angazhim për të vërtetuar
- d. Angazhim direkt
- e. Angazhim për dhënien e sigurisë
- f. Alternativa a) dhe b)
- g. Alternativat a), b) dhe e)
- h. Asnjë nga alternativat e mësipërme

Përgjigje e saktë është alternativa C

PYETJE ME SHTJELLIM (4 pikë secila pyetje)

1. Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, që kryen auditim ligjor të njërive ekonomike me interes publik, brenda tre muajve pas mbylljes së vitit financiar, publikon në faqen zyrtare të internetit një raport për transparencën. Përmendni 8 (tetë) nga elementët që duhet të përfshijë ky raport.

Përgjigje:

Në Nenin 45 të ligjit 10091” Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” trajtohet “Raporti për transparencën” sipas të cilit:

Eksperti kontabël ose shoqëria audituese, që kryen auditimin ligjor të “njësive ekonomike me interes publik” brenda tre muajve pas mbylljes së vitit financiar, publikon në faqen zyrtare të internetit një raport për transparencën, ku përfshihen të paktën:

- a) përshkrimi i strukturës ligjore dhe i pronësisë;
- b) përshkrimi i rrjetit, kur shoqëria e auditimit i përket një rrjeti;
- c) përshkrimi i strukturës drejtuese të shoqërisë së auditimit;
- ç) përshkrimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërisë së auditimit;
- d) informacioni për kryerjen e kontrollit të fundit të cilësisë;
- dh) lista e “njësive ekonomike me interes publik”, për të cilat është kryer auditimi ligjor gjatë vitit të fundit nga shoqëria e auditimit;
- e) deklaratat e praktikave të pavarësisë së shoqërisë audituese;
- ë) deklarata për politikën e ndjekur nga shoqëria audituese, për kualifikimin e vijueshëm profesional të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- f) informacioni financiar, në të cilin tregohet rëndësia e shoqërisë së auditimit, përfshirë qarkullimin, gjithsej, të ndarë në të ardhurat nga tarifat e auditimit ligjor, nga tarifat për shërbimet e tjera, nga këshillimet tatimore dhe shërbime të tjera joauditimi.
- g) informacion në lidhje me bazat për shpërblimin e ortakëve të angazhimit.

2. Çfarë janë rreziku i auditimit, rreziku i anomalisë materiale dhe rreziku i moszbulimit?

Përgjigje:

Rreziku i auditimit - Rreziku që audituesi të shprehë një opinion auditimi të papërshtatshëm, kur në të vërtetë pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale. Rreziku i auditimit është një funksion i rrezikut të anomalisë materiale dhe rrezikut të moszbulimit.

Rreziku i anomalisë materiale (në kontekstin e SNAS 3000 (i rishikuar)) – Rreziku që informacioni i çështjes në fjalë të ketë patur anomali materiale përpara angazhimit.

Rreziku i moszbulimit - Rreziku që procedurat e kryera nga audituesi për të zvogëluar rrezikun e auditimit në një nivel të ulët të pranueshëm, nuk do të arrijnë të zbulojnë një anomali që ekziston dhe që mund të jetë materiale qoftë e vetme, ashtu edhe kur ajo bashkohet me anomali të tjera.

3. Cilat janë pohimet e auditimit në lidhje me gjendjet e llogarive në fund të vitit që zakonisht nuk mund të adresohen nga procedurat e mëposhtme të auditimit.
 - a. Konfirmimi nga palët e treta i borxhit tregtar
 - b. Numërimi fizik i inventarit
 - c. Verifikimi i dokumenteve të titullit të pronësisë së aktiveve afatgjata materiale.

Përgjigje:

Pohimet e auditimit në lidhje me gjendjet e llogarive në fund të vitit që nuk mund të adresohen zakonisht nga procedurat e mëposhtme të auditimit janë:

1) Konfirmimi i jashtëm i borxhit tregtar
- Plotësia.

2) Numërimi fizik i inventarit
- Vlerësimi
- Të drejtat dhe detyrimet.

3) Verifikimi i dokumenteve të titullit të pronësisë së aktiveve afatgjata materiale.
- Ekzistenca
- Plotësia

4. Diskutoni se si procedurat analitike mund të përdoren si procedura thelbësore të auditimit për të siguruar evidenca auditimi. Ilustroni përgjigjen tuaj me një shembull.

Përgjigje:

Procedurat analitike mund të përdoren në fazën e planifikimit të auditimit, gjatë rishikimit të pasqyrave financiare dhe/ ose si procedura thelbësore gjatë auditimit të zërave të caktuar materiale të pasqyrave financiare. **(1 pikë)**

Procedurat analitike konsistojnë në analizën e raporteve dhe trendeve, si dhe në investigimin e luhatjeve apo devijancave të pashpjegueshme apo të paarsyeshme të tyre; krahasimet me informacione të ngjashme në periudhat e mëparshme; krahasimet me buxhetet; krahasimet me parashikimet e përgatitura nga auditorët; si dhe krahasimet me industrinë. **(1 pikë)**

Një shembull i një procedure analitike që konsiderohet një testim thelbësor është testimi i amortizimit dhe zhvlerësimit vjetor të aktiveve afatgjata materiale të entitetit. Në këtë test, auditori parashikon sa do të ishte shuma vjetore e amortizimit dhe zhvlerësimit duke përdorur politikën kontabël të klientit për amortizimin dhe duke e aplikuar këtë mbi shumat e aktiveve afatgjata të trupëzuara dhe jo të trupëzuara të paraqitura në pasqyrat financiare të audituara të një viti të mëparshëm si dhe në shtesat dhe pakësimet për vitin. Shifra që rezulton nga ky testim krahasohet me shumën e pasqyruar në draft pasqyrat financiare për të vlerësuar arsyeshmërinë dhe saktësinë e shpenzimit të njohur. **(2 pikë për saktësinë dhe relevancën e shembullit)**

5. Përkufizoni një opinion kundër auditimi sipas SNA 705 “Modifikimet e Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur”? Përmendni 3 (tre) shembuj se kur mund të lëshohet ky opinion?

Përgjigje:

Sipas SNA 705 “Modifikimet e opinionit në raportin e audituesit të pavarur”, audituesi do të shprehë një opinion kundër kur ai, pasi ka siguruar evidencën e nevojshme të auditimit, arrin në përfundimin se anomali të në pasqyrat financiare, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura. **(1 pike)**

Shembuj të tilla mund të jenë por nuk do të limitohen vetëm në sa më poshtë:

- Nje shoqeri nuk konsolidon ne pasqyrat financiare nje filial i cili konsiderohet “Entitet i kontrolluar i konsiderueshem” per aktivitetet e grupit. Anomalia eshte materiale dhe e perhapur. Audituesi ka marre evidence te mjaftueshme dhe te pershtatshme dhe opinionin e tij nuk eshte ne pajtim me Drejtimin.
- Në qoftë se pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën kontabël të vijimësisë por, sipas gjykimit të audituesit, përdorimi nga drejtimi i vijimësisë në pasqyrat financiare është i papërshtatshëm, për audituesin zbatohet kërkesa që të shprehë një opinion kundër pavarësisht nëse pasqyrat financiare përfshijnë apo jo informacione të dhëna për papërshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi i bazës kontabël të vijimësisë.
- Nje shoqeri ka një numër të madh të mjeteve dhe detyrimeve financiare njohja dhe matja e të cilëve preken nga i SNRF9, 'Instrumentet financiar'. Meqenese zbatimi i standardit te ri ka qene i veshtire per tu aplikuar nga njesia ekonomike, Drejtuesit, kane marre vendim per ta shtyre zbatimin e tij ne periudhen raportuese te ardhshme. Anomalia eshte materiale dhe e perhapur. Audituesi ka marre evidence te mjaftueshme dhe te pershtatshme dhe opinionin e tij nuk eshte ne pajtim me Drejtimin.

***Pergjigjet e kandidateve do te pranohen nese gjate shembujve qe permenden identifikojne 2 faktore kryesore:
a- Kur natyra e ceshtjes qe sjell ne modifikim e lidhet me faktin se pasqyrat financiare jane keq paraqitur materialisht;
b- gjykimi i audituesit ne lidhje me perhapjen e efekteve ose efekteve te mundshme ne Pasqyrat Financiare jane materiale por dhe te perhapura.*

6. Përmendni 2 (dy) situata në të cilat audituesi modifikon opinionin e tij lidhur me ngjarje ose rrethana të cilat mund të hedhin një dyshim të madh për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë. Specifikoni tipin e opinionit të modifikuar të lëshuar në situatat e përmendura.

Përgjigje:

Audituesi vendos të modifikojë opinionin në rastet e mëposhtme (kërkohët që të jepen dy situata):

1. Kur pasiguria lidhur me vijimësinë është materiale dhe supozimet e përdorura nga drejtimi mbi vijimësinë janë të sakta; por informacionet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare lidhur me vijimësinë nuk janë të përshtatshme. **(1 pikë)**

Në këtë rast opinionin është i kualifikuar ose kundër. **(1 pikë)**

2. Kur pasiguria lidhur me vijimësinë është materiale dhe audituesi gjykon se supozimet e përdorura nga drejtimi mbi vijimësinë janë të pasakta sakta. **(1 pikë)**

Në këtë rast opinionin është kundër. **(1 pikë)**

3. Kur drejtimi nuk pranon të bëjë vlerësime lidhur me vijimësinë. **(1 pikë)**

Në këtë rast opinionin është i kualifikuar ose refuzim për dhënie opinion. **(1 pikë)**

7. Shpjegoni çfarë është një paragraf “Theksim çështje” në një raport auditimi? Jepni dy shembuj se kur mund të përdoret/lëshohet ky paragraf?

Përgjigje:

Paragraf që Thekson Çështje – një paragraf që përfshihet në raportin e audituesit, i cili i referohet një çështjeje të paraqitur ose të shpjeguar në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare, e cila sipas gjykimit të audituesit, është me shumë rëndësi, pasi është thelbësore për kuptimin e pasqyrave financiare nga ana e përdoruesve. (2 pike)

Shembuj të rrethanave kur audituesi mund të konsiderojë të nevojshme të përfshijë një Paragraf që Thekson Çështje, janë:

- Një pasiguri në lidhje me rezultatin e ardhshëm të një çështje gjyqësore ose të një veprimi rregullator;
- Një ngjarje e mëvonshme sinjifikative që ndodh midis datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të audituesit;
- Zbatimi i mëhershëm (kur lejohet) i një standardi të ri të kontabilitetit që ka efekt material në pasqyrat financiare;
- Një katastrofë e madhe që ka pasur ose vazhdon të ketë një efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar të entitetit.

***Nese kandidati ka ilustruar ne shembujt, rastet qe I perkasin njeres prej kategorive qe permenden me lart do te marre 1 pike per cdo shembull/ilustrim te permendur.*

8. SNA 560 “Ngjarjet e Mëvonshme” jep udhëzime për përgjegjësitë e audituesit lidhur me ngjarjet e mëvonshme. Shpjegoni shkurtimisht përgjegjësitë e auditorëve për faktet e zbuluara pas datës së raportit të audituesit, por para datës së publikimit të pasqyrave financiare; si dhe faktet e zbuluara pasi të jenë lëshuar/ publikuar pasqyrat financiare të shoqërisë.

Përgjigje:

Audituesi duhet të dizenojë dhe kryejë procedura auditimi të atilla që sigurojnë marrjen e evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme që të gjitha ngjarjet deri në datën e raportit të audituesit, që mund të kërkojnë ndryshime ose paraqitje në pasqyrat financiare, janë identifikuar dhe reflektuar në paqyrat financiare. Këto procedura duhet të zhvillohen sa më afër datës së raportit të audituesit. **(1 pikë)**

Audituesi nuk ka detyrim të ndërmarrë procedura auditimi lidhur me pasqyrat financiare pas datës së raportit të tij. **(0.5 pikë)** Midis kësaj date dhe datës së lëshimit/ publikimit të pasqyrat financiare të shoqërisë së audituar, është përgjegjësia e drejtimit të informojë audituesin për çdo fakt që mund të ndikojnë në pasqyrat financiare. **(0.5 pikë)**

Nëse lindin fakte të tilla dhe audituesi bëhet me dije, audituesi vlerëson nëse pasqyrat financiare kanë nevojë për ndryshime, diskuton çështjen drejtimin dhe ndërmerr e veprimet e duhura. Nëse pasqyrat financiare ndryshohen, audituesi lëshon një raport të ri **(0.5 pikë)**. Nëse drejtimi refuzon të bëjë ndryshimet e kërkuara, audituesi do të modifikojë opinionin e tij. **(0.5 pikë)**.

Pas datës së lëshimit/ publikimit të pasqyrave financiare të shoqërisë, audituesi nuk ka asnjë detyrim për të bërë procedura lidhur me pasqyrat financiare. **(0.5 pikë)**. Kur audituesi bëhet i vetëdijshëm për faktet që mund të ndikojnë në pasqyrat financiare pasi këto të jenë lëshuar, audituesi vlerëson marrjen e masave dhe i diskuton ato me drejtimin. Nëse bëhen ndryshime në pasqyrat financiare, audituesi do të lëshojë një raport të ri i cili do të përfshijë një paragraf të theksimit të çështjes duke iu referuar një shënimi në pasqyrat financiare që diskuton në më shumë detaje arsyet për pasqyrat financiare të rishikuara. **(0.5 pikë)**.

9. Çfarë përcakton standardi për dokumentimin sipas SNSL/ISRS 4400 “Standardet Ndërkombëtare të Shërbimeve të Lidhura - Angazhimet për të Kryer Procedura të Rëna Dakord në Lidhje me Informacionin Financiar”?

Përgjigje:

Sipas SNSL/ISRS 4400 Standardet Ndërkombëtare të Shërbimeve të Lidhura - Angazhimet për të Kryer Procedura të Rëna Dakord në Lidhje me Informacionin Financiar, audituesi duhet të

dokumentojë çështjet të cilat janë të rëndësishme në sigurimin e provave për të mbështetur raportimin e gjetjeve faktike, dhe provave që angazhimi është kryer në përputhje me këtë ISRS dhe kushtet e angazhimit

10. Përshkruani veprimet që duhet të ndjekë audituesi nëse drejtimi refuzon të sigurojë Deklaratën e Përfaqësimit për një çështje të veçantë.

Përgjigje:

Nëse Drejtimi nuk siguron një ose më shumë nga deklaratimet e kërkuara me shkrim, audituesi do të:

- (i) Vlerësojë nëse ka evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit që mund të merren nga burime të tjera;
- (ii) Nëse evidenca të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit nuk mund të merren nga burime të tjera, kjo do të përbëjë një kufizim të fushës dhe audituesi duhet të shprehë një opinion me rezervë ose refuzim për të dhënë një opinionit në pajtim me SNA 705
- (iii) Rivlerësoni integritetin e Drejtimit dhe vlerësojë efektin që kjo mund të ketë në besueshmërinë e përfaqësimeve (me gojë ose me shkrim) dhe në përgjithësi për evidencat e auditimit; dhe
- (iv) Marrë parasysh implikimet e mundshme që mund të ketë refuzimi në raportin e audituesit.
- (v) Rishikojë vazhdimin e angazhimit me këtë klient auditimi.

USHTRIME (5 pikë secili ushtrim)

Ushtrimi 1

Ju jeni një drejtues auditimi në Shoqërinë B&Co Shpk dhe ju është caktuar auditimi i A&Co Sha, filial i një Shoqërie të huaj të listuar e cila ka qenë klient auditimi për tetë vite. Shoqëria është e specializuar në prodhimin e instrumentave muzikore.

Ortaku A ishte ortaku i angazhimit të auditimit për A&Co Sha dhe pasi përfundoi shtatë vite si ortak auditimi i këtij angazhimi, u largua nga ky angazhim. Ortaku aktual i auditimit, Ortaku B, ka sugjeruar që Ortaku A duhet të marrë rolin e ortakut të pavarur të rishikimit për këtë vit, në mënyrë që të mbajë një marrëdhënie të ngushtë me A&Co Sha.

Gjithashtu, A&Co Sha ka kërkuar që Ortaku A t'i ndihmojë ata duke marrë pjesë në mbledhjet e komitetit të tyre të auditimit, pasi drejtori jo-ekzekutiv është larguar së fundmi nga Shoqëria.

A&Co Sha i ka kërkuar Ortakut B dhe ortakëve të tjerë në shoqërinë B&Co Shpk për t'i ndihmuar ata në rekrutimin e një drejtori të ri jo-ekzekutiv.

Tarifat totale të përfituara nga B&Co Shpk nga shërbimet për A&Co Sha për vitin e kaluar janë 16% të të ardhurave totale nga tarifat e auditimit të Shoqërisë së auditimit. Tarifa e auditimit për vitin aktual nuk është konfirmuar ende, por së bashku me taksat dhe tarifat tjera të mundshme të auditimit, të ardhurat totale nga A&Co Sha këtë vit mund të jenë më të mëdha krahasimisht me vitin e kaluar. Tarifa e auditimit të vitit të kaluar po paguhej çdo muaj rregullisht nga A&Co Sha, por për tre muajt e fundit nuk janë bërë ende pagesa.

Manaxheri i auditimit të B&Co Sha sapo ka njoftuar se po largohet nga shoqëria e auditimit B&Co Shpk për t'u punësuar tek A&Co Sha si kontrollues financiar.

Kërkohet:

Duke përdorur informacionin e mësipërm:

Identifikoni dhe shpjegoni PESË kërcënimet etike të cilat mund të ndikojnë në pavarësinë e B&Co Shpk lidhur me auditimin e A&Co Sha.

Përgjigje:

1 – Meqënëse një nga drejtuesit jo-ekzekutiv është larguar së fundi nga Shoqëria dhe drejtuesit e shoqërisë i kanë kërkuar Ortakut A që t'i ndihmojë ata duke marrë pjesë në mbledhjet e komitetit të tyre të auditimit, kjo praktikë paraqet një konflikt interesi për Ortakun A, për më tepër që drejtuesi i larguar ka qenë një drejtues jo-ekzekutiv që kanë një rol shumë të rëndësishëm e mbi të gjitha të pavarur në çështjet e lidhura me mbikqyrjen dhe rregullimin e procesit të auditimit. Ky rol nuk mund të realizohet pa cënim të pavarësisë duke marrë në konsideratë lidhjen afatgjatë që ortaku A ka patur me këtë shoqëri në rolin e tij si ortak i angazhimit të auditimit.

2 – Gjithashtu, ortaku A gjendet në pozitën e konfliktit të interesit edhe në rolin e sugjeruar për asistencë në zgjedhjen e një drejtuesi të ri jo-ekzekutiv. Kjo pasi personi që do të zgjidhet do të ketë rol shumë të rëndësishëm e mbi të gjitha të pavarur në çështjet e lidhura me mbikqyrjen dhe rregullimin e procesit të auditimit (përfshirë përzgjedhjen e shoqërisë audituese). Vetë Shoqëria audituese nuk mund të angazhohet në procese rekrutimi për persona që do të kenë një rol kyç në mbikqyrjen e procesit të auditimit si dhe të shoqërisë audituese.

3 – Ortaku i pavarur i sugjeruar për rishikimin e cilësisë ka qenë në rolin e ortakut të angazhimit për shtatë vitet e kaluara. Kjo përfaqëson një konflikt interesi pasi ekziston rreziku i familjaritetit meqënëse ortaku ka qenë për një kohë të gjatë i përfshirë në këtë angazhim e për rrjedhojë mund të mos ketë skepticizmin e nevojshëm profesional, ose objektivitetin dhe pavarësinë e kërkuar për kryerjen e këtij roli.

4- Tarifat e larta të këtij angazhimi që priten të jenë edhe më të larta se niveli aktual i 16% të të ardhurave totale të shoqërisë B&Co e vendosin shoqërinë audituese në një konflikt potencial interesi, pasi rritet varësia e shoqërisë B&Co ndaj A&Co (që gjeneron një pjesë të rëndësishme të të ardhurave të saj totale) e për rrjedhojë shoqëria audituese mund të ulë ushtrimin e gjykimit të saj profesional, si dhe të rrezikojë humbjen e

objektivitetit nga frika e humbjes së një klienti kaq të madh. Nga ana tjetër, mos pagesa e disa nga kësteve të tarifave të auditimit, mund ta vendosë shoqërinë audituese në një konflikt akoma më të lartë ku gjykimi profesional dhe objektiviteti çënohen nga frika e mos-mbledhjes së të gjitha tarifave të dakorduara.

5 – Angazhimi i manaxherit të auditimit me shoqërinë A&Co në rolin e kontrolluesit financiar mund të paraqesë nga ana tjetër një konflikt interesi. Kjo lëvizje mund të shkaktojë humbje të gjykitimit profesional në mbylljen e çështjeve të auditimit aktual. Nga ana tjetër, edhe për vitet e ardhshme, anëtarët e ekipit të ri të angazhimit të auditimit mund të gjenden në pozita të vështira për të vendosur në pikëpyetje, apo për të ndryshuar qëndrimet e ekipit të mëparshëm të auditimit (nëse identifikohen raste të tilla), ku pjesëmarrës ka qenë një profesionist që tani ka një rol të rëndësishëm në strukturën e shoqërisë që po auditohet.

Ushtrimi 2

Gjatë auditimit të një shoqërie prodhuese, ju keni vërejtur disa çështje që hedhin dyshime të mëdha në aftësinë e shoqërisë për të vijuar aktivitetin normal të saj. Ju keni pasur një takim me drejtimin e shoqërisë për të diskutuar këtë çështje dhe keni komunikuar vendimin tuaj si auditues se një theksim vëmendje mbi këtë çështje në raportin e auditimit është i pashmangshëm. Drejtimi nuk pajtohet dhe ju vuri në dispozicion planin e tij për të suportuar që pasiguria e vijimësisë nuk ekziston.

Plani kryesisht përmban masat e mëposhtme:

- (i) Shoqërisë i garantohet një mbështetje e vazhdueshme financiare nga shoqëria mëmë.
- (ii) Kohët e fundit ka ristrukturuar të gjitha huatë e marra.
- (iii) Drejtimi ka plane për të zvogëluar shpenzimet e përgjithshme dhe shpenzimet administrative.
- (iv) Drejtimi ka plane që të ndërpresë një segment jo-fitimprurës.
- (v) Drejtimi pret operacione fitimprurëse në vitin e ardhshëm.

Kërkohet:

Përshkruani procedurat e auditimit që duhet të kryhen për të mbledhur evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për të mbështetur vlerësimin dhe për të vlerësuar qëndrueshmërinë e masave të mësipërme të drejtimit.

Përgjigje:

Secila nga pikat e mëposhtme ka nga 1 pikë

Procedurat e mëposhtme duhet të kryhen për të vlerësuar qëndrueshmërinë e planeve të Drejtimit.

(i) Mbështetje financiare nga kompania mëmë

- Duhet të merret një kopje të marrëveshjes ligjore të derueshme ndërmjet shoqërisë mëmë dhe kompanisë degë që është në procedurë auditimi.
- Të vlerësohet aftësinë e shoqërisë mëmë për të mbështetur dhe kompanino degë që është në procedurë auditimi.

(ii) Ristrukturimi i huave

- Të sigurohen kontratat dhe planet e reja të pagesave për ristrukturimev
- Të merren konfirmime nga ana e bankave.

(iii) Reduktimi i shpenzimeve të përgjithshme

- Rishikoni minutat e mbledhjeve të Drejtorëve që përmbajnë këto vendime
- Vlerësoni praktikueshmërinë për të zvogëluar shpenzimet e përgjithshme.

(iv) Ndërprerja e segmentit jo-fitimprurës

- Rishikoni minutat e mbledhjeve të Drejtorëve që përmbajnë këto vendime
- Konsideroni ndikimin e shitjes
- Merrni marrëveshjen e shitjes.

(v) Operacione fitimprurëse

- Merrni supozimet e përdorura për të përgatitur parashikimin
- Vlerësoni arsyeshmërinë e supozimit
- Kryeni kontroll aritmetik
- Kontrolloni nëse parashikimet janë në përputhje me supozimet.
- Rishikoni pasqyrat financiare më të fundit të ndërmjetme për të krahasuar rezultatet e vitit deri më sot me parashikimin.

Ushtrimi 3

ABC Sh.p.k prodhon smartphone dhe tableta. Klientët kryesorë të tij janë shitësit me pakicë të cilët më pas i shesin tek publiku i gjerë. Prodhimi i Shoqërisë është shpërndarë në pesë pika dhe mallrat ruhen në nëntë magazinat e saj të vendosura në të gjithë vendin. Ju jeni manaxheri i auditimit të ABC Sh.p.k dhe në përgatitje të planit të auditimit për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020. ABC Sh.p.k ka një departament të vogël të auditimit të brendshëm. Gjatë vitit, ABC Sh.p.k filloi një program të verifikimit fizik të aktiveve afatgjata të Shoqërisë dhe krahasimin e rezultateve me regjistrin këtyre aktiveve, pasi ky rakordim nuk kishte ndodhur prej disa kohësh. Deri më tani vetëm 15% e aktiveve janë konfirmuar pasi ABC Sh.p.k ka pasur mungesa të konsiderueshme të stafit të auditimit të brendshëm dhe disa anëtarë të ekipit aktual të departamentit të auditimit të brendshëm janë të sapopunësuar.

Kërkohet:

Identifikoni dhe shpjegoni mangësitë dhe anomalitë në kontrollin e brendshëm dhe rekomandimit për përmirësimin e kontrollit.

Përgjigje:

Mungesa e kontrollit

Verifikimi fizik i aktiveve afatgjata të kompanisë dhe rakordimin me regjistrin e tyre është kryer për një kohë të gjatë. Ky proces ka filluar, por është përfunduar vetëm në nivelin 15%, për shkak të mungesës së stafit

Rekomandimi i kontrollit

Burime shtesë duhet të angazohen në përfundimin e verifikimit fizik të të gjitha aktive afatgjata që ndodhen në regjistër. Nëse ndonjë aktiv nuk mund të gjendet fizikisht atëherë ai duhet të fshihet nga regjistri kontabël.

Mungesa e kontrollit

Nëse aktivet afatgjata materiale/jomateriale nuk verifikohen/numërohen rregullisht ekziston rreziku i keqpërdorimit ose zhvendosjes së tyre pasi nuk ka kontroll që pasuritë akoma ekzistojnë në vendin e tyre të saktë

Rekomandimi i kontrollit

Pas përfundimit të rishikimi të plotë që është në proces, në baza mujore, një kampion i aktiveve afatgjata materiale/jomateriale duhet të rakordohet me regjistrin kontabël me qëllim konfirmimin e ekzistencës së tyre.

Mungesa e kontrollit

ABC sh.p.k ka hasur në mungesa të konsiderueshme të personelit brenda departamentit të auditimit të brendshëm. Përveç kësaj, disa anëtarë të ekipit aktual të ABC sh.p.k janë të rinj në kompani.

Rekomandimi i kontrollit

Drejtimi duhet të konsiderojë rekrutimin e punonjësve shtesë dhe me eksperience në departamentin e auditimit të brendshëm.

Mungesa e kontrollit

Pasja e një departamenti të auditimit të brendshëm është një kontroll i rëndësishëm pasi i mundëson Drejtimit të lartë të provojë nëse kontrollet po funksionojnë në mënyrë efektive brenda kompanisë. Nëse ekipi ka mungesë stafi ose mungesë eksperience, kjo zvogëlon efektivitetin e monitorimit të këtij kontrolli.

Rekomandimi i kontrollit

Në periudha të ndërmjetme, punonjësit nga departamentet e tjera, të tilla si financa, etj mund të transferojnë dhe mund të suportojnë departamentin e auditimit me auditimet e brendshme, me kusht puna e tyre të mos konsistojë në rishikime që kanë të bëjnë me kontrollet që operojnë në departamentin ku punonjësit zakonisht punojnë.

Ushtrimi 4

Ju jeni manaxheri i angazhimit për auditimin e Shoqërisë XYZ shpk. Për të kryer vlerësimin e rrezikut në përputhje me SNA 315, janë kryer procedura analitike të të dhënave financiare të Shoqërisë XYZ shpk, përmes analizës së raporteve financiare.

Kërkohe:

Përcaktoni gabimin / mashtrimin e mundshëm dhe përgjigjet ndaj rrezikut nëse procedurat analitike zbulojnë sa më poshtë:

- a. Ulje në raportin e shpejtë
- b. Rritje në qarkullimin e inventarit
- c. Rritje në qarkullimin e llogarive të arkëtueshme
- d. Ulje në raportin e borxhit
- e. Rritja e marzhit bruto

Përgjigje:

a.1 Gabim në vlerën e inventari (nënvlerësim)

- Kontrolloni inventarin në kontabilitet me inventarin fizik -sasitë në fletët e numërimit
- Kontrolloni çmimin e inventarit
- Konsideroni nëse zhvlerësimi i vlerës së inventarit për vjetërsim nuk është i gabuar

a.2 Mbivlerësimi i llogarive të pagueshme dhe përlllogaritjeve

- Kontrolloni pagesat e mëpasshme
- Kontrolloni faturat e furnitorëve

b. Rritja e qarkullimit të inventarit

- Nënvlerësim i vlerës mbylljes së inventarit

c. Rritja e qarkullimit të llogarive të arkëtueshme

- Nënvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

d. Ulje në raportin e borxheve

Qiraja financiare trajtohet edhe njihet në pasqyrën e të ardhurave edhe shpenzimeve

- Inspektoni kushtet qiranë për njohjen sipas SNRF 16
- Zbatoni kriteret për klasifikimin e qirasë në pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën e të ardhurave edhe shpenzimeve

e. Rritja e marzhit bruto

- Mbivlerësimi i vlerës mbylljese së inventarit
- Nënvlerësimi i kostos së shitjeve.

Ushtrimi 5

ABC Sh.p.k prodhon pjesë automjetesh dhe fundi i vitit financiar është 31 dhjetor 2020. Paraja në bankë dhe paraja e gatshme e përfshirë në versionin paraprak të pa audituar të pasqyrave financiare të ABC Sh.p.k përbëhen nga disa llogari bankare: një overdraft prej 5.1 milion Lekë që është llogaria kryesore rrjedhëse e kompanisë dhe 0.2 milion Lekë në disa llogari kursimi. Drejtori i financave ka informuar menaxherin e auditimit se të gjitha llogaritë janë rakorduar në fund të vitit. Overdrafti prej 5.1 milion Lekë është rritur ndjeshëm që nga viti i kaluar (2019:1.2 milion Lekë). Drejtimi ju ka informuar që struktura e overdraftit, me të cilën kompania operon në baza ditore, pritet të rinovohet në mars 2021 dhe se ata janë të sigurt se do të rinovohet.

Kërkohet:

Përshkruani procedurat thelbësore që auditori duhet të kryejë për të marrë evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit në lidhje me gjendjet bankare të ABC Sh.p.k.

Përgjigje:

Procedurat thelbësore që audituesi në lidhje me gjendjet e bankës që audituesi duhet të ndjekë janë:

- Të merren konfirmime bankare nga të gjitha bankat për të gjitha llogaritë bankare të ABC sh.p.k
- Rakordoni të gjitha llogaritë e shënuara në letrën e konfirmimit të bankës me rakordimet bankare të kompanisë ose me gjendjet kontabël apo librin e madh për të siguruar plotësinë e gjendjeve të bankës.
- Për llogarinë rrjedhëse, merrni konfirmimin bankar të ABC sh.p.k dhe kontrolloni shtesat për të siguruar saktësinë aritmetike
- Rakordoni gjendjet sipas rakordimit bankar me deklaratën/statement origjinale të bankës në fund të vitit dhe me letrën e konfirmimit të bankës.
- Rakordoni gjendjen e parave të gatshme sipas kontabilitetit me numërimin fizik të parave të gatshme në fund të vitit.
- Rishikoni lëvizjet e parave të gatshme dhe deklaratat bankare për ndonjë transaksion të pazakontë ose transferta në vlera të mëdha rreth fundit të vitit
- Kontrolloni letrën e konfirmimit të bankës për detaje të çdo sigurie/garancie të dhënë nga ABC sh.p.k, në lidhje me overdraftet e bankës ose ndonjë të ndonjë të drejtë ligjore pasi kjo mund të kërkojë paraqitje shtesë në pasqyrat financiare.
- Për llogaritë e kursimeve, rishikoni çdo çështje në rakordimet e bankave të fundvitit dhe bini dakord për të mbështetur dokumentacionin.
- Rishikoni pasqyrat financiare për të siguruar që paraqitjet dhe shënimet për gjendjet bankare janë të plota, të sakta dhe i klasifikuara sic duhet midis ndërmjet aktiveve rrjedhëse dhe pasiveve rrjedhëse.

Ushtrimi 6

Shoqëria Iliria Cement Sh.p.k e cila merret me prodhimin dhe tregtimin e çimentos, po përgatit pasqyrat financiare për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2021. Paqyrat financiare duhet të përgatiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Shoqëria nuk aplikon ndonjë ligj apo rregullore tjetër lokale. Pasqyrat financiare përfshijnë: Pasqyrën e pozicionit financiar, Paqyrën e fitim/humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në kapital, dhe Pasqyrën e lëvizjes së flukseve të mjeteve monetare. Audituesve të jashtëm u kërkohet që të raportojnë për aksionarët e Shoqërisë për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2021.

Audituesit kanë evidentuar se Shoqëria zotëron një furrë për pjekjen e çimentos dhe aplikon një politikë kontabël që nuk përlllogarit zhvlerësimin për to. Audituesit kanë arritur në përfundimin se kjo politikë kontabël nuk është në përputhje me SNK 16 'Aktivet materiale', dhe anomalia e identifikuar është materiale, por nuk është e përhapur në nivel pasqyrash financiare në periudhën aktuale apo edhe në ato të paraardhëse. Drejtimi nuk ka amenduar pasqyrat financiare, por ka përfshirë një shpjegim në Shënimin shpjegues 1 të pasqyrave. Materialiteti i audituesve i percaktuar është për 31 dhjetor 2021 është 30 mln Lekë. Aktivet materiale në Pasqyrën e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2020 janë 42 mln Lekë ndërsa në 31 dhjetor 2020 janë 19 mln Lekë.

Kërkohej:

Përcaktoni se çfarë lloj opinionit do të lëshojë audituesi? Përgatisni një ekstrakt ku të përmbajë paragrafin e opinionit, bazën për dhënie opinionit dhe çdo paragraf tjetër që mendoni se është relevant për rastin e shpjeguar më lart dhe është pjesë përbërëse e raportit të auditimit?

Përgjigje:

- 1- Lloji i raportit sipas elementeve që përshkruhen më lart do të jetë I modifikuar, opinionit me rezerve (1 pike). Arsyeja qëndron sepse anomalia e identifikuar nga audituesi është materiale, por, nuk është e përhapur. Fakti që Drejtimi ka vendosur shpjegim në shënimin 1, nuk është i mjaftueshëm për të treguar se Aktivet Afatgjata Materiale janë vlerësuar siç duhet në përputhje me SNK16. (1 pike)
- 2- Ekstrakti i bazës për opinionin dhe opinionit do të ilustruhet si më poshtë:

Opinionit me rezerve (1 pike)

Në kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare Iliria Cement shpk, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin e bazës për opinionin me rezerve të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkelidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjithë aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të Iliria Cement shpk në datën 31 dhjetor 2021, performancën financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këto date përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Baza për opinionin me rezerve (2 pike)

Ashtu siç përshkruhet në Shënimin Shpjegues 1 të pasqyrave financiare, Shoqëria Iliria Cement aplikon një politikë që nuk njeh zhvlerësimin furrës që shërben për pjekjen e çimentos. Sipas opinionit tonë, kjo politikë nuk është në përputhje me SNK 16 'Aktivet materiale'. Duke aplikuar një zhvlerësim **linear me normë xx% në vit, shpenzimi shtesë i zhvlerësimit për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2021 do të ishte xxx Lekë. Gjithashtu, aktivet materiale do të zvogëlohen në masën e zhvlerësimit të akumuluar prej xxx Lekë. Humbja e vitit dhe deficiti i akumuluar do të rritet me xxx Lekë dhe xxx Lekë respektivisht për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2021

Në kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë I vendosur nga Bordi I Kontabilistëve Për Standardet Ndërkombëtare të Etikës së Kontabilistëve ("BSKNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave

financiare ne Shqiperi si edhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

*** Do te konsiderohet e pranueshme edhe nese kandidati ka gjykuar per nje tjetër baze te zhvleresimit te furrës bazuar ne njesi prodhimi dhe jo ne njesi kohore.*

Ushtrimi 7

Shoqëria Ferma Bio Sh.p.k po përgatit pasqyrat financiare për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2021. Paqyrat financiare duhet të përgatiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Shoqëria nuk aplikon ndonjë ligj apo rregullore tjetër lokale. Paqyrat financiare përfshijnë: Pasqyrën e Pozicionit Financiar, Pasqyrën e fitim/humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe Pasqyrën e lëvizjes së flukseve të mjeteve monetare. Audituesve të jashtëm u kërkohet që të raportojnë për aksionarët e Shoqërisë për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2021.

Audituesit e jashtëm nuk ishin emëruar deri pas mbylljes së periudhës raportuese, dhe, për këtë shkak, nuk vëzhguan inventarizimin fizik në fillim dhe në fund të vitit. Audituesit nuk ishin në gjendje të realizonin procedura alternative në këtë drejtim.

Gjithashtu, futja e sistemit të ri të kompjuterizuar për sistemin e llogarive të arkëtueshme në shtator 2020 ka rezultuar në një numër të konsiderueshëm gabimesh në llogaritë e arkëtueshme, të cilat nuk janë identifikuar plotësisht në datën e lëshimit të raportit të auditimit.

Materialiteti i audituesve i përcaktuar për 31 dhjetor 2021 është 100 mln Lekë. Totali i aktiveve në Pasqyrën e pozicionit financiar për 31 dhjetor 2021 është 125 mln Lekë ndërsa në 31 dhjetor 2020 është 150 mln Lekë. Zëri i inventarit për 31 dhjetor 2021 përbën 50% të totalit të aktivitetit ndërsa llogaritë e arkëtueshme përbëjnë 40% të totalit të aktivitetit. Më 31 dhjetor 2020 inventari përbënte 35% të totalit të aktivitetit ndërsa llogaritë e arkëtueshme përbënin 35% të totalit të aktivitetit.

Kërkohet:

Përcaktoni se çfarë lloj opinionit do të lëshojë audituesi? Përgatisni një ekstrakt ku të përmbajë paragrafin e opinionit, bazën për dhënie opinionit dhe çdo paragraf tjetër që mendoni se është relevant për rastin e shpjeguar më lart dhe është pjesë përbërëse e raportit të auditimit?

Përgjigje:

1-Lloji i raportit sipas elementeve që përkruhen më lart do të jetë i modifikuar, Refuzim dhënie opinionit (1 pike). Arsyeja qëndron sepse natyra e çështjes që çon në modifikim lidhet me pamundësinë për të marrë evidencën e nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe gjykimi i audituesit në lidhje me përhapjen e efekteve ose efekteve të mundshme në pasqyrat financiare është material dhe i përhapur. Në 2021 zeri i inventare dhe llogaritë të arkëtueshme përbejnë 90% të totalit të aktivitetit dhe në 2020 përbejnë 70% gje që tregojnë se anomalitë nëse do të identifikoheshin do të ishin të përhapura por edhe materiale. (1 pike)

2- Me poshtë paraqiten në mënyrë ilustrative ekstraktet e bazës për refuzim dhënie opinionit, opinionit dhe e përgjegjësisë së audituesit e cilat në rastin e refuzim dhënie opinionit ndryshojnë nga llojet e tjera të raporteve të modifikuara. Secili prej paragrafeve do të vlerësohet me nga 1 pike.

Refuzimi i dhënies së opinionit (1 pike)

Ne u angazhuam për të kryer auditimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë Ferma Bio Sh.p.k të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitim/ humbjes dhe e të ardhurave

gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë bashkëlidhur . Për shkak të rëndësisë së çeshtjeve të përshkruara në paragrafin e Bazës për Refuzimin e Opinionit të raportit tonë, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit që do të na jepte një bazë për një opinion auditimi mbi këto pasqyra financiare.

Baza për refuzimin e dhënies së opinionit (1 pike)

Ne nuk ishim emëruar si auditues të Shoqërisë deri pas 31 dhjetor 2021, dhe, për këtë shkak, nuk vëzhguan inventarizimin fizik në fillim dhe në fund të vitit. Ne nuk ishim në gjendje të bindeshim me mjete të tjera alternative për gjendjen e inventarit më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2021, të cilat janë paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar me shumat respektive 62.5 mln Leke dhe 75 mln Leke. Përveç kësaj, implementimi i një sistemi të ri të kompjuterizuar për sistemin e llogarive të arkëtueshme në shtator 2020 ka rezultuar në një numër të konsiderueshëm gabimesh në llogaritë e arkëtueshme. Deri në datën e raportit të audituesit, drejtimi ishte ende në procesin e rakordimit të mangësive të sistemit dhe korrigjimin e gabimeve. Ne nuk ishim në gjendje të konfirmonim apo testonim përmes procedurave alternative llogaritë e arkëtueshme në Pasqyrën e Pozicionit Financiar në shumën 50 mln Leke më 31 dhjetor 2021. Si rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse do të kishte qenë e nevojshme të bëhej ndonjë korrigjim në lidhje me inventarët e regjistruar apo të paregjistruar, llogaritë e arkëtueshme dhe elementët që përbëjnë pasqyrën e fitim/ humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalet e veta dhe pasqyrën e fluksese monetare.

Përgjegjësia e audituesit (1 pike)

Përgjegjësia jonë është është të kryejmë një auditim të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe të leshojmë një raport audituesi. Megjithatë, për shkak të çështjes së përshkruar në paragrafin e bazës për refuzimin e opinionit, ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencën e nevojshme të auditimit që të na jepte një bazë për opinionin e auditimit mbi këto pasqyra financiare.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikes së Kontabilistëve Profesioniste I vendosur nga Bordi I Kontabilistëve Per Standardet Nderkombetare te Etikes se Kontabilistëve (“BSKNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri si edhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ushtrimi 8

Shoqëria Jurdon Sh.p.k po përgatit pasqyrat financiare për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2021. Pasqyrat financiare duhet të përgatiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Shoqëria nuk aplikon ndonjë ligj apo rregullore tjetër lokale. Pasqyrat financiare përfshijnë: Pasqyrën e Pozicionit Financiar, Pasqyrën e fitim/humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe Pasqyrën e lëvizjes së flukseve të mjeteve monetare. Audituesit të jashtëm i kërkohet që të raportojë për aksionaret e Shoqërisë për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2021.

Drejtimi i Jurdon shpk ka përlllogaritur një provigjion për çështje gjyqësore në pasqyrat financiare prej 50 mln Lekë. Audituesi ka marrë evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme dhe pajtohet me konkluzionin e drejtimit se është e përshtatshme përlllogaritja e këtij provigjioni dhe ka arritur në konkluzionin se dhënia e informacionit shpjegues për bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare është i përshtatshëm.

Materialiteti i audituesve për 31 dhjetor 2021 është 40 mln Lekë. Totali i aktiveve në Pasqyrën e pozicionit financiar për 31 dhjetor 2021 është 100 mln Lekë ndërsa në 31 dhjetor 2020 është 150 mln Lekë.

Kërkohet:

Përcaktoni se çfarë lloj opiniononi do të lëshojë audituesi? Përgatisni një ekstrakt ku të përmbajë paragrafin e opinionit, bazën për dhënie opinionit dhe çdo paragraf tjetër që mendoni se është relevant për rastin e shpjeguar më lart dhe është pjesë përbërëse e raportit të auditimit?

Përgjigje:

- 1- Lloji i raportit sipas elementëve që përshkruhen më lart do jetë i pamodifikuar, opinionit standard (1 pikë). Arsyeja qëndron sepse audituesi ka marrë evidencë të mjaftueshme dhe përshtatshme dhe pajtohet me konkluzionin e drejtimit se është e përshtatshme përlogaritja e këtij provigjioni dhe ka arritur në konkluzionin se dhënia e informacionit shpjegues për bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare është i përshtatshëm. (1 pikë)
- 2- Ekstrakti i bazës për opinion, opinionit dhe çështje për tu theksuar do të ilustruhet si më poshtë dhe do të vlerësohet me nga një pikë secila. Shembuj të rrethanave kur audituesi mund të konsiderojë të nevojshme të përfshijë një Paragraf që Thekson Çështje, janë: Një pasiguri në lidhje me rezultatin e ardhshëm të një çështje gjyqësore ose të një veprimi rregullator. Në rastin e përshkruar më lart provigjioni I llogaritur për çështje gjyqësore është më i lartë se materialiteti dhe 50% e totalit të aktiveve, ndaj, për rëndësinë që shfaq, do ishte e nevojshme të tërhiqte vëmendjen e përdoruesve të informacionit financiar.

Opinionit (1 pikë)

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Jurdon shpk (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitim humbjes dhe e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejte, në të gjitha aspektet materiale, (*ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për*), pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin (1 pikë)

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesioniste I vendosur nga Bordi I Kontabilistëve Per Standardet Nderkombetare te Etikës së Kontabilistëve (“BSKNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri si edhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes (1 pikë)

Ne tërheqim vëmendjen për Shenimin xx të këtyre pasqyrave financiare, i cili përshkruan pasigurinë lidhur me rezultatin e çështje gjyqësore të paraqitura kundër Shoqërisë . Opinionit ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Ushtrimi 9

Shoqëria Mëma Sh.p.k po përgatit pasqyrat financiare për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2021. Paqyrat financiare duhet të përgatiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Shoqëria nuk aplikon ndonjë ligj apo rregullore tjetër lokale. Paqyrat financiare përfshijnë: Pasqyrën e Pozicionit Financiar, Pasqyrën e fitim/humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe Pasqyrën e lëvizjes së flukseve të mjeteve monetare. Audituesve të jashtëm u kërkohet që të raportojnë për aksionarët e Shoqërisë për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2021.

Mëma Sh.p.k ka disa filiale, një prej të cilëve (Shoqëria Bija Sh.p.k), e blerë gjatë vitit. Mëma Sh.p.k përgatit pasqyra financiare të konsoliduara, siç kërkohet nga *SNA 27 'Pasqyra financiare të konsoliduara dhe të veçanta'*, por ka përjashtuar Bija Sh.p.k nga konsolidimi për shkak se drejtimi nuk ka përcaktuar ende vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të Bijes në datën e blerjes, siç kërkohet nga *SNRF 3 'Kombinimi i biznesit'*. Investimi është matur dhe paraqitur me kosto në pasqyrat financiare.

Materialiteti i audituesve për 31 dhjetor 2021 është 90 mln Lekë. Totali i aktiveve në Pasqyrën e pozicionit financiar për 31 dhjetor 2021 është 125 mln Lekë, ndërsa në 31 dhjetor 2020 është 150 mln Lekë. Zëri i filialit për 31 dhjetor 2021 përbën 90% të totalit të aktivitetit ndërsa për 31 dhjetor 2020 përbente 85% të totalit të aktivitetit.

Kërkohet:

Përcaktoni se çfarë lloj opinionit do të lëshojë audituesi? Përgatisni një ekstrakt ku të përmbajë paragrafin e opinionit, bazën për dhënie opinionit dhe çdo paragraf tjetër që mendoni se është relevant për rastin e shpjeguar më lart dhe është pjesë përbërëse e raportit të auditimit?

Përgjigje:

1-Lloji i raportit sipas elementëve që përshkruhen më lart do jetë I modifikuar, opinion i kundërt (1 pikë). Arsyeja qëndron sepse natyra e çështjes që çon në modifikim lidhet me faktin se pasqyrat financiare janë keqparaqitur materialisht dhe gjykimi i audituesit në lidhje me përhapjen e efekteve ose efekteve të mundshme në pasqyrat financiare është material dhe I përhapur. Zëri i filialit për 31 dhjetor 2021 përbën 90% të totalit të aktivitetit ndërsa për 31 dhjetor 2020 përbente 85% të totalit të aktivitetit, pra duke treguar që përbën një pjesë të konsiderueshme të totalit të aktiveve të pasqyrave financiare të mëmës.

- 2- Më poshtë paraqiten në mënyrë ilustrative ekstraktet e opinionit të kundërt, bazës për opinion të kundërt.

Opinionit kundër (1 pikë)

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë Mema shpk filialeve të saj (Grupi), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitim humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse të konsoliduar, pasqyrën e ndryshimeve në kapital të konsoliduar dhe pasqyrën e flukseve monetare të konsoliduar për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin e bazës për opinionin kundër, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkelidhur, nuk paraqesin në mënyrë të drejtë, ne të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit në datën 31 dhjetor 2021, performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Baza për opinionin kundër (2 pikë)

Siz përshkruhet në Shënimin Shpjegues xx të pasqyrave financiare, Grupi nuk ka konsoliduar në pasqyrat financiare filialin Bijë shpk, të blerë gjatë vitit 2021, pasi nuk ka qenë në gjendje të përcaktojë vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve materiale të filialit në datën e blerjes. Për këtë arsye, ky investim është njohur bazuar në kosto. Sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, filiali duhej të ishte konsoliduar, pasi ai kontrollohet nga Shoqëria . Nëse Shoqëria Bijë shpk do të ishte konsoliduar, shumë elementë në pasqyrat financiare do të ishin ndikuar materialisht. Efektet e moskonsolidimit në pasqyrat financiare të konsoliduara nuk janë përcaktuar.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesioniste I vendosur nga Bordi I Kontabilistëve Per Standardet Nderkombetare te Etikës së Kontabilistëve (“BSKNE”) dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri si edhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të kundërt.

Ushtrimi 10

Ju jeni ortak i auditimit për shoqërinë Alpha Shpk, për të cilën në datën 12 shkurt 2021, është lëshuar një opinion pa rezervë për pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Pasqyrat financiare pritet të aprovohen në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionerëve, e cila do të mbahet ditën e martë, 23 mars 2021. Sot data është 5 mars 2021.

Ju sapo jeni njoftuar nga drejtimi i shoqërisë Alpha Shpk se në datën 4 mars 2021, gjykata vendosi në favor të Gamma Shpk, një klienti të shoqërisë Alpha Shpk, duke e shpallur Shoqërinë Alpha Shpk përgjegjëse për shkelje teknike të kontratës së shërbimit me klientin e saj; dhe duke i kërkuar kështu të paguajë të gjithë dëmet e lidhura me këtë shkelje, që arrijnë një shumë materiale.

Audituesi ishte në dijeni të faktit se Gamma Shpk kishte filluar më 21 dhjetor 2020 procedurat ligjore kundër shoqërisë Alpha Shpk, duke ngritur pretendim për shkeljen e kontratës. Më 29 dhjetor 2020, këshilltarët ligjorë të Alpha Shpk informuan drejtimin se nuk kishte gjasa që shoqëria të shpallej me përgjegjësi lidhur me këtë pretendim; prandaj Alpha Shpk nuk kishte njohur asnjë provizion në pasqyrat financiare, edhe pse në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ishte dhënë informacion shpjegues si një pasiv i kushtëzuar.

Kërkohet

- a) **A përbën ky fakt një ngjarje që kërkon ndryshime në pasqyrat financiare të shoqërisë Alpha Shpk?**
- b) **Cilat janë përgjegjësitë tuaja si auditues lidhur me këtë ngjarje të mëpasshme dhe çfarë veprimi duhet të ndërmerreni duke marrë në konsideratë faktin që Alpha Shpk ka vendosur të ndryshojë pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 nën dritën e faktit të ri?**
- c) **Si duhet të veproni nëse shoqëria Alpha Shpk ju informon se drejtimi është i vendosur për të mos bërë asnjë ndryshim në pasqyrat financiare lidhur me këtë fakt?**

Përgjigje:

- a) **Ngjarja kërkon ndryshime në pasqyrat financiare të shoqërisë Alpha shpk pasi:**

- kushtet ekzistojnë që para datës së pasqyrave financiare, pra 31 dhjetor 2020, pasi padia gjyqësore kundër shoqërisë Alpha shpk kishte filluar që në datën 21 dhjetor 2020. **(0.5 pikë)**
 - kriteret e njohjes për një provizion në përputhje me kërkesat e SNK 37 janë përmbushur. **(0.5 pikë)**
- b) SNA 560 jep udhëzime lidhur me ngjarjet e vëna në dijeni të audituesit pas datës së raportit të audituesit, por para datës së aprovimit dhe lëshimit të pasqyrave financiare. Në kushtet kur Alpha shpk ka vendosur të ndryshojë pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, audituesi duhet:
- Të kryejë procedura të reja auditimi lidhur me ngjarjen e mëpasshme për të marrë siguri lidhur me nevojën për këto ndryshime dhe saktësinë e provizionit. **(1 pikë)**
 - Të lëshojë një raport të ri të audituesit lidhur me pasqyrat e ndryshuara financiare të shoqërisë Alpha shpk për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Raporti i ri duhet të ketë një datë të mëpasshme se data e ndryshimit të pasqyrave financiare nga ana e shoqërisë. **(1 pikë)**
- c) Në kushtet kur Alpha shpk ka vendosur të mos ndryshojë pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020; si dhe në kushtet kur audituesi vlerëson që në fakt ndryshimi do të ishte i nevojshëm pasi përbën një ngjarje që kërkon ndryshim, audituesi duhet të konsiderojë si më poshtë:
- Të marrë të gjitha masat e nevojshme që sigurojnë se palët e treta nuk e përdorin dhe nuk mbështeten në raportin e audituesit. **(1 pikë)**
 - Audituesi mund të marrë në konsideratë dorëheqjen nga angazhimi. **(1 pikë)**